

VENDIM
Nr. 1021, datë 27.11.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të pakësohet fondi prej 20 900 000 (njëzet milionë e nëntëqind mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07450 “Shërbimet e shëndetit publik”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të pakësohet fondi prej 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”, artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara”, të shtohet fondi prej 24 300 000 (njëzet e katër milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama